

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtaret Hasan Shala, kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Mediha Jusufi dhe Gani Avdiu, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses Korportata Energjetike e Kosovës – Sh.a. Divizioni I Furnizimit Distrikti në Gjilan, të cilin me autorizim e përfaqëson D.R., kundër të paditurit H.XH. nga fshati ..., Komuna e Vitisë, me bazë juridike pagesa e borxhit në shumë prej 1.830,46 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.nr.177/2009 të datës 11.06.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 25.05.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

VËRTETOHET aktgjykimi Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.nr.177/2009 të datës 11.06.2013, gjersa:

NDRYSHOHET i njëjti aktgjykim C.nr.177/2009 të datës 11.06.2013 sa i përket llogaritjes së kamatës për pagesën e borxhit, ashtu që gjykohet si vijon: **OBLIGOHET** i padituri H.XH., nga fshati ... Komuna e Vitisë që paditëses t'ia paguaj shumat e gjykuara, me kamatën të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim me afat përtej një viti e pa destinim të përcaktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjyqimit me dt. 11.06.2013, gjer në pagesën definitive.

REFUZOHET ankesa e të paditurit H.XH., nga fshati ... Komuna e Vitisë, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C.nr.177/2009 të datës 11.06.2013. I.Aprovohet kërkesëpadia e Korportata Energjetike e Kosovës – Sh.a. Divizioni I Furnizimit Distrikti në Gjilan, dhe detyrohet i padituri H.XH. nga fshati ... K. Viti ta përmbush borxhin ndaj paditëses për shpenzimin e energjisë elektrike në shtëpinë e tij në fshatin ... me shifër të njehësorit DGL 38437 për periudhën kohore shtator 2007 qershor 2013 në shumë prej 1.830,46 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kamat prej 8 % vjetore duke filluar nga data 11.06.2013 deri në pagesën e fundit. Obligohet i padituri që

paditëses që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore për taksa gjyqësore në shumë prej 25 euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka parashtruar ankesë i padituri, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK nga neni 182 i LPK, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike nga neni 183 i LPK dhe zbatimi i gabuar të së drejtës materiale nga neni 184 i LPK. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit gjersa aktgjykimi i sulmuar me ankesë në pajtim me dispozitën e nenit 195.1 të LPK do ta ndryshoj sipas pretendimeve ankimore ose ta prish aktgjykimin e goditur dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar-

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka ushtruar propozim për përmbarim në bazë të dokumentit autentik. Mirëpo debitori ka ushtruar kundërshtim kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr.960/08 dt. 10.02.2009. Gjykata propozimin e ka trajtuar si padi dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë prova të mjaftueshme siç janë: Faturën e datës 25.09.2008 për shpenzimin e energjisë elektrike me shifër të njehërosit DGL 38437 në shumë prej 4.452,32 euro, transaksionin e konsumatorit për të paditurin për periudhën kohore shtator 2002 qershor 2013 në shumë prej 5.694,70 euro, është bërë precizomi i padisë nga përfaqësuesi i paditëses për periudhën kohore shtator 2007 qershor 2013. Andaj duke u bazuar në këto prova të cekura më lartë gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në pjesërisht e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 pika 2 të LPK-së, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale. Gjithashtu janë të pabazuara pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje qenësore. Meqë aktgjykimi i atakuar nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestua ligjshmërinë e këtij aktgjykimi, meqë me prova të mjaftueshme dhe me fakte vendimtare vërtetohet ligjshmëria e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, që do të thotë se aktgjykimi i ankimuar është i qartë, preciz e konciz dhe si i tillë është dokument i përshtatshëm përmbarues.

Nga të cekurat me lartë rezulton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë si dhe aplikimi i të drejtës materiale nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 378 par.1 i LMD-së. Ky pretendim ankimor i të paditurit nuk qëndron ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerjen e parashkrimit të borxhit të parapara me nenin 387 të LMD-së, e cila dispozitë i ka përcaktuar kushtet për ndërprerjen e parashkrimit të borxhit dhe ato siç janë: pohimi i borxhit, ndërprerja e parashkrimit realizohet me ngritjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të paditësit, të ndërmarr kundër të paditurit në gjykatë. Mirëpo në qoftë se është ndërpre afati i parashkrimit në kohë të caktuar pas kalimit të këtij afati fillon të rrjedhë afati nga fillimi, kurse afati që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim që do të thotë se me rastin e pohimit të borxhit nga ana e të paditurit parashkrimi fillon të rrjedhë nga fillimi prej ditës se pohimit të borxhit, kurse koha e kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim. Nëse ndërprerja e parashkrimit të borxhit ka filluar me ushtrimin e padisë, parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri prej ditës kur kontesti është përfunduar. Për ndërprerjen e parashkrimit nuk është e mjaftueshme vetëm ftesa e paditësit (kreditorit) drejtuar të paditurit (debitorit), që përmbush detyrimin por është e nevojshme që paditësi (kreditorit) të ndërmarr veprimin gjegjësisht para gjykatës për realizimin e kërkesës së vet. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur të paditurin e ka obliguar që të paguaj shumën në vlerë prej 1.830,46 €, ngase këtë borxh i padituri nuk e ka paguar dhe se i njëjti këtë borxh e ka pranuar duke e paguar kohë pas kohe. Ky fakt vërtetohet në bazë të transaksionit të konsumatorit nr.38437. Andaj për këtë arsye vjen në shprehje zbatimi i dispozitës 387 LMD-së, mbi ndërprerjen e parashkrimit ngase këtu mund të vërtetohet me pagesën e kohëpaskohshme të borxhit, vjen gjer te pohimi i borxhit nga ana e të paditurit.

Kolegji I Gjykatës së Apelit, sipas detyrës zyrtare konstaton se vendimi përkitazi me kamatën e pranuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar është zbatuar në mënyrë jo të drejtë në kundërshtim me dispozitat e nenit 277 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, ngase kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me dispozitën e lartcekur, meqë kamata e pranuar në lartësi prej 8 % është në kundërshtim me dispozitat ligjore të cituara më lartë meqë raportet juridiko civile në mes të ndërgjyqësve janë krijuar në kohën kur ishte në fuqi Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore i ish RSFJ gjerësa kamata prej 8% është përcaktuar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore të Kosovës i cili ligj nuk ka qenë në fuqi kur janë krijuar raportet juridiko civile në mes të ndërgjyqësve. Andaj duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e aprovuar, aktgjykimi i shkallës së parë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke u bazuar në dispozitën e lartcekur, kjo gjykatë vendosi që ta ndryshoi aktgjykimin edhe në këtë pjesë ku është vendosur lidhur me pagesën e shumës së caktuar me kamatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe njëherit duke përcaktuar datën e llogaritjes së kamatës nga dita kur është marrë aktgjykimi.

Duke marr parasysh pretendimet ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendime ankimore janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të LPK-së, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së. Gjithashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale të cilën të drejtë gjykata e shkallës së dytë e vështron sipas detyrës zyrtare.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 195.1, pika d), dhe nenit 200, të LPK-së.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.3692/2013, datë 25.05.2016

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI,
Hasan Shala